



**Numri i lëndës:** KSC-BC-2023-10

**Prokurorja e Specializuar k. Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit  
dhe Haxhi Shalës**

**Vendosi:** Trupi Gjykues I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, Kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 13 nëntor 2024

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

### Vendim mbi Informimin në Tërësi të Dëshmitarëve

---

**T'u njoftohet:**

**Prokurores së Specializuar**  
Kimbërli P. Uest

**Mbrojtjes së Sabit Januzit**  
Xhonatan Elistan Ris

**Mbrojtjes së Ismet Bahtijarit**  
Felisiti Geri

**Mbrojtjes së Haxhi Shalës**  
Tobi Kadman

**TRUPI GJYKUES I** (Trupi Gjykues) merr këtë vendim për informimin në tërësi të dëshmitarëve.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 24 shtator 2024, Trupi Gjykues kërkoi nga palët dhe nga Administratorja/Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve (ZMMD) të dorëzonin parashtrime, ndër të tjera, lidhur me informimin e dëshmitarëve para dhënies së dëshmisë, duke mbajtur parasysh praktikën e Trupit Gjykues në çështjen gjyqësore KSC-BC-2020-04 (Çështja 04).<sup>1</sup>

2. Nga 28 shtatori deri më 4 tetor 2024, Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS dhe Parashtrimet e ZPS-së),<sup>2</sup> Mbrojtja e Ismet Bahtijarit (Mbrojtja e Bahtijarit, Parashtrimet e Bahtijarit dhe Parashtrimet e Mëtejshme të Bahtijarit),<sup>3</sup> Mbrojtja e Haxhi Shalës (Mbrojtja e Shalës dhe Parashtrimet e Shalës)<sup>4</sup> dhe Administratorja/ZMMD-ja (Parashtrimet e Administratores)<sup>5</sup> bënë parashtrimet e

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2023-10, F00479, Trupi Gjykues I, [Decision setting the dates for trial preparation conferences, requesting submissions and on related matters](#) (Vendim mbi Caktimin e Datave të Konferencave Përgatitore për Gjykimin, mbi Parashtrime nga Palët dhe mbi Çështje të Lidhura me To), 24 shtator 2024, publik, para. 12, 15, 32(c).

<sup>2</sup> KSC-BC-2023-10, F00491, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë para Mbajtjes së Konferencave Përgatitore për Gjykimin*, 1 tetor 2024, konfidenciale, me Shtojcën 1, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik i parashtrimeve u dorëzua më 4 tetor 2024, F00491/RED.

<sup>3</sup> KSC-BC-2023-10, F00494, Mbrojtja e Bahtijarit, *Parashtrime të Bahtijarit lidhur me Përgatitjen e Gjyimit në bazë të Vendimit F00479*, 2 tetor 2024, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik i parashtrimeve u dorëzua më 18 tetor 2024, F00494/RED; F00502, Mbrojtja e Bahtijarit, *Parashtrime të Mëtejshme të Bahtijarit lidhur me Përgatitjen e Gjyimit në bazë të Vendimit F00479*, 4 tetor 2024, konfidenciale. Një version i redaktuar publik i parashtrimeve të mëtejshme u dorëzua më 21 tetor 2024, F00502/RED.

<sup>4</sup> KSC-BC-2023-10, F00482, Mbrojtja e Shalës, *Parashtrim nga Mbrojtja e Haxhi Shalës i Informacioneve me Shkrim të Specifikuara në Paragrafët 12-20 të Vendimit F00479*, 28 shtator 2024, publik, me Shtojcën 1, publike.

<sup>5</sup> KSC-BC-2023-10, F00490, Zyra Administrative, *Parashtrime të Zyrës Administrative për Konferencat Përgatitore për Gjykimin*, 1 tetor 2024, publike, me Shtojcën 1, konfidenciale, dhe Shtojcat 2 deri 5, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

tyre. Mbrojtja e Sabit Januzit (Mbrojtja e Januzit) nuk bëri parashtrime në këtë aspekt.<sup>6</sup>

3. Më 16 tetor 2024, pas udhëzimeve të mëtejshme të Trupit Gjykses,<sup>7</sup> Mbrojtja e Bahtijarit (Parashtrimet e Bahtijarit lidhur me Përgatitjen e Dëshmitarëve)<sup>8</sup> dhe Mbrojtja e Shalës (Parashtrimet e Shalës lidhur me Përgatitjen e Dëshmitarëve)<sup>9</sup> dorëzuan parashtrime lidhur me përgatitjen e dëshmitarëve. Mbrojtja e Januzit nuk bëri parashtrime në këtë aspekt.

4. Më 21 tetor 2024, ZPS-ja dorëzoi kundërpërgjigje ndaj Parashtrimeve të Bahtijarit lidhur me Përgatitjen e Dëshmitarëve dhe Parashtrimeve të Shalës lidhur me Përgatitjen e Dëshmitarëve (Kundërpërgjigjja e ZPS-së).<sup>10</sup>

5. Më 28 tetor 2024, Mbrojtja e Bahtijarit dorëzoi kundërpërgjigje ndaj Kundërpërgjigjes së ZPS-së (Kundërpërgjigjja e Bahtijarit ndaj Kundërpërgjigjes së ZPS-së).<sup>11</sup>

---

<sup>6</sup> KSC-BC-2023-10, F00495, Mbrojtja e Januzit, *Parashtrime për Konferencat Përgatitore për Gjykimin në Emër të Januzit*, 1 tetor 2024, publike.

<sup>7</sup> KSC-BC-2023-10, Transkripti i seancës, 8 tetor 2024, publik, f. 368, rreshti 11 deri f. 369, rreshti 4.

<sup>8</sup> KSC-BC-2023-10, F00535, Mbrojtja e Bahtijarit, *Parashtrime të Bahtijarit lidhur me Përgatitjen e Dëshmitarëve dhe Informimin në Tërësi të Dëshmitarëve*, 16 tetor 2024, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik i parashtrimeve u dorëzua më 5 nëntor 2024, F00535/RED.

<sup>9</sup> KSC-BC-2023-10, F00536, Mbrojtja e Shalës, *Parashtrim lidhur me Praktikën e Përgatitjes së Dëshmitarëve*, 16 tetor 2024, publik.

<sup>10</sup> KSC-BC-2023-10, F00544, Prokurorja e Specializuar, *Kundërpërgjigje e Prokurorisë ndaj Parashtrimeve të Mbrojtjes lidhur me Përgatitjen e Dëshmitarëve*, 21 tetor 2024, konfidenciale. Një version i redaktuar publik i kundërpërgjigjes u dorëzua më 23 tetor 2024, F00544/RED.

<sup>11</sup> KSC-BC-2023-10, F00565, Mbrojtja e Bahtijarit, *Kundërpërgjigje e Bahtijarit ndaj Kundërpërgjigjes së Prokurorisë ndaj Parashtrimeve të Mbrojtjes lidhur me Përgatitjen e Dëshmitarëve*, F00544, 28 tetor 2024, konfidenciale.

## II. PARASHTRIMET

### A. PARASHTRIMET E ZPS-SË

6. ZPS-ja parashtron se konfirmon qëndrimin që ka mbajtur në Çështjen 04 dhe në çështjen gjyqësore KSC-BC-2020-05 (Çështja 05) sa i takon dobisë që kanë seancat përgatitore të palës thirrëse me dëshmitarët.<sup>12</sup>

7. Më konkretisht, ZPS-ja parashtron se: (i) megjithëse në kornizën ligjore të Dhomave të Specializuara nuk ka dispozita specifike mbi praktikën e përgatitjes së dëshmitarëve, ajo është lejuar nga gjykatat në Kosovë dhe tani është kodifikuar edhe në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës të vitit 2022, Kodi Nr. 08/L-032 (KPPK),<sup>13</sup> si dhe zbatohet gjerësisht në institucionet gjyqësore ndërkombëtare/hibride;<sup>14</sup> (ii) përgatitja e dëshmitarëve e kryer siç duhet kontribuon në dhënien e dëshmimeve relevante, të sakta dhe të fokusuara dhe në mirëqenien e dëshmitarëve;<sup>15</sup> dhe (iii) përgatitja e dëshmitarëve mund të jetë sidomos e përshtatshme të kryhet në rastet kur dihet se ekziston atmosfera e frikësimit të dëshmitarëve, sepse përgatitja i jep mundësi palës thirrëse të përpiqet t'ua zbusë frikën dëshmitarëve dhe të marrë informacione të tjera relevante lidhur me ndërhyrjet ndaj dëshmitarëve që nga kontakti i fundit me ta.<sup>16</sup>

8. ZPS-ja kërkon më tej që palët të ftohen të konsultohen dhe, në qoftë se është e mundur, të bëjnë parashtrime të përbashkëta lidhur me përgatitjen e

---

<sup>12</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 16-22.

<sup>13</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 17.

<sup>14</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 17.

<sup>15</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 18.

<sup>16</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 16, 19-21.

dëshmitarëve, si edhe të dorëzojnë një projekt-protokoll për “informimin”, me udhëzimet dhe garancitë mbrojtëse përkatëse.<sup>17</sup>

#### B. PARASHTRIMET E BAHTIJARIT DHE PARASHTRIMET E MËTEJSHME TË BAHTIJARIT

9. Mbrojtja e Bahtijarit parashtron se, megjithëse pajtohet të ndjekë praktikën informimit të dëshmitarëve të përdorur në Çështjen 04,<sup>18</sup> kundërshton praktikën e përgatitjes së dëshmitarëve të propozuar nga ZPS-ja.<sup>19</sup>

#### C. PARASHTRIMET E SHALËS

10. Mbrojtja e Shalës parashtron se nuk ka kundërshtim ndaj praktikës së informimit të dëshmitarëve të përdorur në Çështjen 04, por kundërshton çdo përgatitje të dëshmitarëve.<sup>20</sup>

#### D. PARASHTRIMET E ADMINISTRATORES

11. Administratorja bën të ditur se nuk ka parashtrime të tjera lidhur me qasjen e Trupit Gjykses ndaj informimit të dëshmitarëve në Çështjen 04 dhe Çështjen 05.<sup>21</sup> Administratorja dorëzon gjithashtu, si shtojcë të parashtrimeve të saj, udhëzuesit dhe udhëzimet e hartuara nga ZMMD-ja për mbështetjen që u jep dëshmitarëve para, gjatë dhe pas dëshmisë së tyre në gjykatë, ku përfshihen praktikat më të mira lidhur me informimin e dëshmitarëve dhe shërbimet e tjera mbështetëse.<sup>22</sup>

---

<sup>17</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 23.

<sup>18</sup> Parashtrimet e Bahtijarit, para. 19.

<sup>19</sup> Parashtrimet e Mëtejshme të Bahtijarit, para. 4. *Shih edhe* Kundërpërgjigjen e Bahtijarit ndaj Kundërpërgjigjes së ZPS-së, para. 4, 21.

<sup>20</sup> Parashtrimet e Shalës, f. 5, para. 15. *Shih edhe* KSC-BC-2023-10, Transkript i seancës, 7 tetor 2024, publik, f. 354, rreshtat 17-19.

<sup>21</sup> Parashtrimet e Administratores, para. 3.

<sup>22</sup> Parashtrimet e Administratores, para. 4; Shtojca 1 e Parashtrimeve të Administratores.

## E. PARASHTRIMET E BAHTIJARIT LIDHUR ME PËRGATITJEN E DËSHMITARËVE

12. Mbrojtja e Bahtijarit përsërit parashtrimet e saj të mëparshme në mbështetje të praktikës të informimit të dëshmitarëve të ndjekur në Çështjen 04.<sup>23</sup>

13. Sa i takon përgatitjes së dëshmitarëve, Mbrojtja e Bahtijarit rithekson kundërshtimin e saj ndaj ndjekjes së kësaj praktike<sup>24</sup> me argumentin se: (i) më së shumti nuk është pranuar në gjykatat dhe tribunallet ndërkombëtarë;<sup>25</sup> (ii) fakti që një formë përgatitjeje e dëshmitarëve është përfshirë në KPPK nuk kufizon diskrecionin e Trupit Gjykses për të vendosur lidhur me zbatimin ose jo të përgatitjes së dëshmitarëve;<sup>26</sup> (iii) Trupi Gjykses vendosi kundër përgatitjes së dëshmitarëve në dy raste të tjera të mëparshme, në Çështjen 04 dhe në Çështjen 05, dhe rrethanat e kësaj çështjeje gjyqësore nuk justifikojnë devijimin nga praktika e mëparshme e Trupit Gjykses;<sup>27</sup> dhe (iv) përgatitja e dëshmitarëve në këtë çështje gjyqësore mund të dëmtojë provat që do të jepen nga dëshmitarët e ZPS-së.<sup>28</sup>

14. Mbrojtja e Bahtijarit parashtron si alternativë se, në qoftë se Trupi Gjykses vendos të devijojë nga jurisprudenca e vet, protokollin për përgatitjen e dëshmitarëve që do të miratohet nga Trupi Gjykses duhet të përfshijë garanci të forta që i mundësojnë Trupit Gjykses dhe palës jothirrëse të kuptojnë se si do të kryhet përgatitja.<sup>29</sup>

---

<sup>23</sup> Parashtrimet e Bahtijarit lidhur me Përgatitjen e Dëshmitarëve, para. 3, 5, 31-33, 34(b).

<sup>24</sup> Parashtrimet e Bahtijarit lidhur me Përgatitjen e Dëshmitarëve, para. 3-4, 34(a).

<sup>25</sup> Parashtrimet e Bahtijarit lidhur me Përgatitjen e Dëshmitarëve, para. 12-14.

<sup>26</sup> Parashtrimet e Bahtijarit lidhur me Përgatitjen e Dëshmitarëve, para. 15.

<sup>27</sup> Parashtrimet e Bahtijarit lidhur me Përgatitjen e Dëshmitarëve, para. 16-22.

<sup>28</sup> Parashtrimet e Bahtijarit lidhur me Përgatitjen e Dëshmitarëve, para. 23-25.

<sup>29</sup> Parashtrimet e Bahtijarit lidhur me Përgatitjen e Dëshmitarëve, para. 26-29, 34(c).

## F. PARASHTRIMET E SHALËS LIDHUR ME PËRGATITJEN E DËSHMITARËVE

15. Mbrojtja e Shalës përsërit mbështetjen e saj për praktikën e informimit të dëshmitarëve të miratuar më parë nga Trupi Gjykses.<sup>30</sup>

16. Sa i takon përgatitjes së dëshmitarëve, Mbrojtja e Shalës bën të ditur se e kundërshton këtë praktikë dhe i referohet arsyetimit të Trupi Gjykses në Vendimin mbi Informimin në Tërësi të Dëshmitarëve në Çështjen 05.<sup>31</sup> Në veçanti, Mbrojtja e Shalës parashtron mes të tjerash se diskutimi me palën thirrëse i aspekteve që lidhen me përmbajtjen e dëshmisë jashtë sallës së gjyqit para dhënies së dëshmisë, bart rrezikun e përcimit të paqëllimshëm të njëfarë pritshmërie të palës thirrëse lidhur me dëshminë që do të jepet, duke ndikuar apo kontaminuar kështu në mënyrë të pavullnetshme dëshmitarin.<sup>32</sup> Krahas kësaj, Mbrojtja e Shalës argumenton se, duke pasur parasysh që ngjarjet objekt i dëshmisë së dëshmitarëve të ZPS-së nuk ka shumë që kanë ndodhur, nuk është e nevojshme që ZPS-ja të kryejë seanca për t'i përgatitur dëshmitarët që të japin dëshmi relevante, të sakta dhe të fokusuara në gjykim.<sup>33</sup>

## G. KUNDËRPËRGJIGJJA E ZPS-SË

17. ZPS-ja kundërpërgjigjet se shqetësimet e shprehura nga Mbrojtja e Bahtijarit dhe Mbrojtja e Shalës mund të trajtohen me anë të një urdhri për zhvillimin e gjykimit ku të përcaktohen kriteret konkrete për përgatitjen e dëshmitarëve, i ngjashëm me atë të çështjes gjyqësore KSC-BC-2020-06 (Çështja 06).<sup>34</sup> ZPS-ja thekson në veçanti se

---

<sup>30</sup> Parashtrimet e Shalës lidhur me Përgatitjen e Dëshmitarëve, para. 18, 24.

<sup>31</sup> Parashtrimet e Shalës lidhur me Përgatitjen e Dëshmitarëve, para. 14-17, 19-20, 22-23 ku mbështetet në KSC-BC-2020-05, F00150, Trupi Gjykses I, [Decision on witness familiarisation](#) (Vendim mbi Informimin në Tërësi të Dëshmitarëve) (Vendimi mbi Informimin e Dëshmitarëve në Çështjen 05), 9 korrik 2021, publik. Shih edhe KSC-BC-2023-10, Transkript i seancës, 7 tetor 2024, publik, f. 355, rreshti 17.

<sup>32</sup> Parashtrimet e Shalës lidhur me Përgatitjen e Dëshmitarëve, para. 19.

<sup>33</sup> Parashtrimet e Shalës lidhur me Përgatitjen e Dëshmitarëve, para. 21.

<sup>34</sup> Kundërpërgjigjja e ZPS-së, para. 2-4.

përgatitja e dëshmitarëve do të mundësonte përdorimin efektiv të kohës në sallën e gjyqit në këtë çështje gjyqësore dhe se do të shmangej paraqitja dhe diskutimi në tërësi i disa provave me dëshmitarin në sallën e gjyqit.<sup>35</sup>

18. Gjithashtu, ZPS-ja është e mendimit se, në kundërshtim me atë që parashtrohet Mbrojtja e Bahtijarit, rrethanat e kësaj çështjeje gjyqësore peshojnë në favor të lejit të përgatitjes së dëshmitarëve. ZPS-ja argumenton mes të tjerash se: (i) kjo çështje ka të bëjë me vepra penale “të konstatuara në çështje gjyqësore në Kosovë” në të cilat zbatohet përgatitja e dëshmitarëve; (ii) traumatizimi i dëshmitarëve, që mund të rrjedhë nga fakti se kjo çështje gjyqësore ka të bëjë, ndër të tjera, me konfirmimin e kërcënimit me vdekje të dëshmitarit të synuar dhe anëtarit të familjes, kur ishin në shtëpi, mund të shihet si faktor që justifikon përgatitjen e dëshmitarëve; dhe (iii) përgatitja e dëshmitarëve përgjithësisht është pranuar në TPNJ /TPNR-së dhe është pranuar në praktikën e GJPN-së të kohëve të fundit. Gjithashtu, ZPS-ja nënvizon rëndësinë e një praktike të unifikuar në të gjithë tribunalët penalë ndërkombëtare dhe në veçanti në DHS.<sup>36</sup>

#### H. KUNDËRPËRGJIGJJA E BAHTIJARIT NDAJ KUNDËRPËRGJIGJES SË ZPS-SË

19. Mbrojtja e Bahtijarit u kundërpërgjigjet argumenteve të ngritura në Kundërpërgjigjen e ZPS-së, duke theksuar se rreziku i ndikimit të parregullt të dëshmitari mund të mos jetë i qëllimshëm apo me keqdashje nga ana e ZPS-së dhe se, në qoftë se përgatitja e dëshmitarëve lejohet, është i domosdoshëm incizimi me zë ose me pamje.<sup>37</sup> Ajo përsërit se vëllimi i provave në këtë çështje gjyqësore është i kufizuar,<sup>38</sup> KPPK-ja nuk zbatohet drejtpërdrejt në këtë çështje gjyqësore<sup>39</sup> dhe rikujton

---

<sup>35</sup> Kundërpërgjigjja e ZPS-së, para. 5.

<sup>36</sup> Kundërpërgjigjja e ZPS-së, para. 2, 6-8.

<sup>37</sup> Kundërpërgjigjja e Bahtijarit ndaj Kundërpërgjigjes së ZPS-së, para. 12-15.

<sup>38</sup> Kundërpërgjigjja e Bahtijarit ndaj Kundërpërgjigjes së ZPS-së, para. 16.

<sup>39</sup> Kundërpërgjigjja e Bahtijarit ndaj Kundërpërgjigjes së ZPS-së, para. 17-18, 20.

se Dhomat e GJPN-së, me vendim të shumicës, nuk e kanë pranuar përgatitjen e dëshmitarëve.<sup>40</sup> Për këtë arsye, Mbrojtja e Bahtijarit parashtron se karakteristikat e kësaj çështjeje gjyqësore nuk justifikojnë përgatitjen e dëshmitarëve.<sup>41</sup>

### III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

20. Trupi Gjykses mbështetet në nenet 34(8) dhe 40(2) dhe (6) të Ligjit nr. 05/L053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji) dhe në rregullat 27, 80 dhe 116 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (Rregullorja).

### IV. ANALIZË

#### A. ASPEKT PARAPRAK

21. Trupi Gjykses vëren se në Kundërpërgjigjen e Bahtijarit ndaj Kundërpërgjigjes së ZPS-së, Mbrojtja e Bahtijarit argumenton se, me qëllim që Trupi Gjykses të marrë informacion të plotë, ajo e gjykon të nevojshme t'i kundërpërgjigjet Kundërpërgjigjes së ZPS-së, për shkak të një numri keqinterpretimesh të parashtrimeve të saj.<sup>42</sup> Trupi Gjykses vëren, megjithatë, se Mbrojtja e Bahtijarit nuk kërkoi leje për të dorëzuar parashtrimet e lartpërmendura dhe nuk ka justifikuar nevojën për parashtrime të tilla, përpos përshkrimit të mëtejshëm të pikave të kontestuara që ishin paraqitur më parë në Parashtrimet e Bahtijarit lidhur me Përgatitjen e Dëshmitarëve. Gjithsesi, Trupi Gjykses vlerëson se nuk ka nevojë për parashtrime të mëtejshme lidhur me përgatitjen e dëshmitarëve. Për pasojë, Trupi Gjykses nuk do ta marrë në konsideratë

---

<sup>40</sup> Kundërpërgjigjja e Bahtijarit ndaj Kundërpërgjigjes së ZPS-së, para. 19.

<sup>41</sup> Kundërpërgjigjja e Bahtijarit ndaj Kundërpërgjigjes së ZPS-së, para. 21.

<sup>42</sup> Kundërpërgjigjja e Bahtijarit ndaj Kundërpërgjigjes së ZPS-së, para. 3-4.

Kundërpërgjigjen e Bahtijarit ndaj Kundërpërgjigjes së ZPS-së në marrjen e këtij vendimi.

#### B. INFORMIMI I DËSHMITARËVE PARA DHËNIES SË DËSHMISË

22. Që në fillim, Trupi Gjykses sqaron se e përdor termin “informimi i dëshmitarëve” për informimin dhe mbështetjen që ZMMD-ja u jep dëshmitarëve përpara dhënies së dëshmisë, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga neni 34(8) i Ligjit dhe nga rregullat 27 dhe 80(8) të Rregullores. Krahas kësaj, Trupi Gjykses përdor termin “përgatitje e dëshmitarëve” për çdo takim mes dëshmitarit dhe palës thirrëse që zhvillohet para dhënies së dëshmisë për të diskutuar për aspekte të ndryshme që lidhen me përmbajtjen e dëshmisë së dëshmitarit.<sup>43</sup>

23. Duke vënë re parashtrimet e Mbrojtjes së Bahtijarit dhe të Mbrojtjes së Shalës lidhur me informimin e dëshmitarëve,<sup>44</sup> si edhe Udhëzimet e ZMMD-së lidhur me Shërbimet për Dëshmitarët që Paraqiten para Dhomave të Specializuara,<sup>45</sup> Trupi Gjykses u jep udhëzimet e mëposhtme ZMMD-së dhe njërive të tjera relevante lidhur me informimin e dëshmitarëve para dhënies së dëshmisë.

---

<sup>43</sup> KSC-BC-2020-04, F00435, Trial Panel I, [Decision on witness familiarisation](#) (Vendim mbi Informimin në Tërësi të Dëshmitarëve) (Vendimi mbi Informimin e Dëshmitarëve në Çështjen 04), 24 shkurt 2023, publik, para. 9. Trupi Gjykses e interpreton “përgatitjen e dëshmitarëve” si një term me kuptim të gjerë, që përfshin një numër shprehjesh, si, ndër të tjera “verifikim i dëshmisë me dëshmitarin” (*witness proofing*), “ aftësim i dëshmitarit (*witness training*)” dhe “udhëzim i dëshmitarit (*witness coaching*)”, që përdoren në juridiksione të ndryshme për praktikën që synojnë përgatitjen e dëshmitarëve për dhënien e dëshmisë gojore. Ngjashëm, ICC/GJPN, *Prosecutor v. Lubanga*, Pre-Trial Chamber I, [Decision on the Practices of Witness Familiarisation and Witness Proofing](#), 8 nëntor 2006, ICC-01/04-01/06-679, publik, para. 12.

<sup>44</sup> *Shih më lart* para. 9, 12, 15.

<sup>45</sup> KSC-BD-42/Rev3, Udhëzim i Zyrës Administrative. Udhëzime të ZMMD-së lidhur me Shërbimet për Dëshmitarët që Paraqiten para Dhomave të Specializuara, 27 shtator 2024, bashkëlidhur si Shtojca 1 e Parashtrimeve të Administtores, f. 24-34 (Udhëzimet e ZMMD-së).

## 1. Informimi fillestar nga pala thirrëse

24. Trupi Gjykses rikujton se pala thirrëse duhet t'i japë ZMMD-së, për secilin dëshmitar, formularin e informacionit mbi dëshmitarin (FID), sa më shpejt që të jetë e mundur por jo më vonë se 35 (tridhjetë e pesë) ditë pune para datës kur pritët të japë dëshminë dëshmitari.<sup>46</sup> Gjithashtu, së paku 30 (ditë) ditë përpara fillimit të secilit bllok dëshmish (ose, për dëshmitarët e planifikuar të dëshmojnë jashtë blloqeve të përcaktuara të dëshmimeve, së paku 30 (tridhjetë) ditë para dhënies së planifikuar të dëshmisë),<sup>47</sup> palët duhet t'i dorëzojnë ZMMD-së listën e përditësuar të paraqitjes së dëshmitarëve (LPD),<sup>48</sup> që përfshin: (i) listën e dëshmitarëve sipas radhës së paraqitjes; (ii) nëse do të dëshmojnë personalisht në selinë e gjykatës, përmes videokonferencës prej një vendi tjetër, apo do të japin dëshmi në ndonjë mënyrë tjetër të përcaktuar në Rregullore;<sup>49</sup> (iii) datën kur secili dëshmitar duhet të paraqitet në vendin e dhënies së dëshmisë; (iv) masat mbrojtëse, në qoftë se ka; (v) gjuhën e dhënies së dëshmisë; dhe (vi) kohëzgjatjen e përlllogaritur të dëshmisë. Për këtë qëllim, ZMMD-ja u vë sa më shpejt në dispozicion palëve formularët tip FID dhe LPD në format të përshtatshëm elektronik.

25. Kur i dorëzon ZMMD-së formularin FID, pala thirrëse e njofton atë për çdo dëshmitar që mund të inkriminojë veten. ZMMD-ja siguron që të informohet Zyra e Mbrojtjes e Zyrës Administrative në rast se nevojitet këshillim juridik sipas rregullës 151(4) të Rregullores.<sup>50</sup>

---

<sup>46</sup> Shih Udhëzimet e ZMMD-së, Pika 4(1)-(2). Shih edhe Vendimin mbi Informimin e Dëshmitarëve në Çështjen 04, para. 11.

<sup>47</sup> Shih KSC-BC-2023-10, F00586, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Zhvillimin e Gjykimit* (Vendimi mbi Zhvillimin e Gjykimit), 11 nëntor 2024, publik, para. 27, 34.

<sup>48</sup> Shih Udhëzimet e ZMMD-së, Pika 4(3). Vendimi mbi Informimin e Dëshmitarëve në Çështjen 04, para. 11.

<sup>49</sup> Shih Rregullat 141(1), 144, 145(1) të Rregullores.

<sup>50</sup> Shih edhe Vendimin mbi Zhvillimin e Gjykimit, para. 64-66. Vendimi mbi Informimin e Dëshmitarëve në Çështjen 04, para. 12.

26. Pala thirrëse mbetet në dispozicion të ZMMD-së për shkëmbimin e informacioneve relevante dhe, aq sa është e mundur, mbledh të gjitha të dhënat relevante që nevojiten.

## **2. Procesi para informimit të dëshmitarëve**

27. Para se të fillojë procesi i informimit, pala thirrëse mundëson një takim prezantues midis ZMMD-së dhe dëshmitarit dhe e informon dëshmitarin se ZMMD-ja do të jetë përgjegjëse për organizimin e udhëtimit të dëshmitarit, sipas rastit, me qëllim dhënien e dëshmisë. ZMMD-ja i shpjegon dëshmitarit shërbimet dhe ndihmën që do t'i japë dhe e informon për tema që kanë të bëjnë me sigurinë, mirëqenien, udhëtimin e logjistikën, strehimin dhe pagesat që i takojnë dëshmitarit. ZMMD-ja do të mundësojë edhe udhëtimin dhe të gjitha aspektet logjistike të nevojshme për të siguruar paraqitjen në kohë të dëshmitarit para DHS-së, duke i kushtuar vëmendje sigurisë dhe mirëqenies së tij.<sup>51</sup>

## **3. Fillimi i procesit të informimit**

28. Në momentin e mbërritjes së dëshmitarit në Holandë për të dëshmuar personalisht në selinë e DHS-së, ose në vendin e përzgjedhur për dhënien e dëshmisë me videokonferencë sipas rregullës 144(2) të Rregullores, apo në një kohë të përshtatshme në rast se dëshmitari do të merret në pyetje në vendin ku banon apo është nën kujdes, sipas rregullës 145(1) të Rregullores, ZMMD-ja i jep dëshmitarit informacion në një takim mirëseardhës dhe orientues dhe i përshkruan programin konkret për paraqitjen e dëshmitarit dhe dhënien e

---

<sup>51</sup> Vendimi mbi Informimin e Dëshmitarëve në Çështjen 04, para. 14.

dëshmisë në DHS , si edhe kalendarin paraprak të paraqitjes në gjykatë, në qoftë se dihet.<sup>52</sup>

29. Gjatë atij takimi, ZMMD-ja kryen vlerësim të cenueshmërisë së dëshmitarit. Një përmbledhje e vlerësimit i dorëzohet drejtpërdrejt Trupit Gjykses para se dëshmitari të japë dëshmi, bashkë me ndonjë rekomandim të përshtatshëm për masa të posaçme sipas rregullës 80(4)(c) të Rregullores. Informacioni për masat e rekomanduara u jepet edhe palëve.<sup>53</sup>

### **1. Afati i fundit për kontakt me palën thirrëse**

30. Me fillimin e procesit të informimit të dëshmitarit, dëshmitari është nën kujdesin e ZMMD-së dhe çdo takim i mëtejshëm mes palës thirrëse dhe këtij dëshmitari jashtë sallës së gjyqit është i ndaluar. Për dëshmitarët që dëshmojnë personalisht në selinë e DHS-së, afati i fundit për kontakt mes palës thirrëse dhe dëshmitarit para dhënies së dëshmisë është mbërritja e dëshmitarit në Holandë. Për dëshmitarët që japin dëshmi nëpërmjet videokonferencës nga një vend tjetër, afati i fundit është data e mbërritjes së dëshmitarit në vendin e dhënies së dëshmisë. Për dëshmitarët që merren në pyetje jashtë vendit ku mbahen seancat e gjykimit, sipas rregullës 145(1) të Rregullores, afati i fundit është data e mbërritjes së ZMMD-së në vendin e dhënies së dëshmisë. Në qoftë se procesi i informimit të dëshmitarit duhet të fillojë përpara afateve të lartpërmendura, ZMMD-ja duhet t'ua komunikojë këtë palëve në kohë të mjaftueshme paraprakisht. ZMMD-ja informon palën thirrëse se kur do të mbërrijë dëshmitari, si edhe në qoftë se ka vonesa madhore.<sup>54</sup>

---

<sup>52</sup> Vendimi mbi Informimin e Dëshmitarëve në Çështjen 04, para. 15.

<sup>53</sup> Vendimi mbi Informimin e Dëshmitarëve në Çështjen 04, para. 16.

<sup>54</sup> Vendimi mbi Informimin e Dëshmitarëve në Çështjen 04, para. 17.

31. Pas këtyre afateve dhe deri sa të përfundojë dhënia e dëshmisë së dëshmitarit, pala thirrëse mund të ketë kontakt me dëshmitarin vetëm për një takim kortezie, siç përshkruhet më gjerë në vijim, dhe për marrjen në pyetje të dëshmitarit në gjykim, përveç nëse Trupi Gjykses autorizon ndryshe. Gjatë kësaj periudhe, ZMMD-ja shërben si ndërlidhëse për komunikimin mes dëshmitarit dhe palës thirrëse, kur është e nevojshme dhe sipas urdhrave të Trupit Gjykses.<sup>55</sup>

32. Kufizimi i lartpërmendur i kontaktit nuk zbatohet për dëshmitarët ekspertë. Diskutimet mes palës thirrëse dhe dëshmitarëve ekspertë të saj mund të kryhen në çdo fazë para thirrjes së këtyre dëshmitarëve.<sup>56</sup>

## **2. Njohja me vendin (e gjykimit)**

33. Në qoftë se dëshmitari dëshmon në selinë e DHS-së, ZMMD-ja e shoqëron dëshmitarin në sallën e gjyqit dhe i tregon si është e organizuar ajo dhe, në qoftë se është e nevojshme, e informon për sistemet e ndryshme që përdoren në gjykatë, duke i kushtuar vëmendje të veçantë zbatimit teknik të masave mbrojtëse dhe/ose të masave të posaçme në sallën e gjyqit, në bazë të rregullës 80 të Rregullores, sipas rastit. Procesi i njohjes me sallën e gjyqit mund të përshtatet për dëshmitarët e cenueshëm, në qoftë se është e nevojshme.<sup>57</sup>

34. Gjithashtu, ZMMD-ja e informon dëshmitarin për natyrën e procedurave në gjykim, organizimin e sallës së gjyqit dhe pjesëmarrësit. Dëshmitarit i tregohen edhe dhomat e pritjes së dëshmitarëve dhe mjedise të tjera që mund të përdorin. Në qoftë se dëshmitari ka nevojë për ndihmë në sallën e gjyqit, aty është i pranishëm edhe ndihmësi, kur është e mundur.<sup>58</sup>

---

<sup>55</sup> Vendimi mbi Informimin e Dëshmitarëve në Çështjen 04, para. 18.

<sup>56</sup> Vendimi mbi Informimin e Dëshmitarëve në Çështjen 04, para. 19.

<sup>57</sup> Vendimi mbi Informimin e Dëshmitarëve në Çështjen 04, para. 21.

<sup>58</sup> Vendimi mbi Informimin e Dëshmitarëve në Çështjen 04, para. 22.

35. Për dëshmitarët që japin dëshmi përmes videokonferencës ose jashtë vendit të gjykimit sipas rregullës 145(1) të Rregullores, ZMMD-ja e përshtat këtë proces, sipas nevojës, dhe siguron që dëshmitarët të njihen mjaftueshëm me sistemet e ndryshme të përdorura në gjykim dhe në vendin e dhënies së dëshmisë, me pjesëmarrësit, si dhe mjediset që mund të përdorin për nevojat e tyre në vendin e dhënies së dëshmisë.<sup>59</sup>

36. Në qoftë se dëshmitari ka nevojë, procesi i informimit mund të përsëritet.<sup>60</sup>

### **3. Takimet e kortezisë me palët**

37. Për t'u dhënë dëshmitarëve mundësinë të njihen me personat që mund t'u bëjnë pyetje në gjykim, para fillimit të procesit të informimit dhe, aq sa është e mundur, palët përkatëse duhet t'i japin ZMMD-së emrat e personave që do të jenë në sallën e gjyqit. Pas kësaj ZMMD-ja organizon një takim kortezie mes dëshmitarit dhe personave të lartpërmendur. Takimet e kortezisë mbahen me secilin subjekt më vete në mjediset e DHS-së dhe në prani të personelit të ZMMD-së. Në rastin e dëshmitarëve që dëshmojnë nëpërmjet videokonferencës, takimi i kortezisë mund të kryhet në distancë, me mjetet e përshtatshme të videokonferencës. Në rastin e dëshmitarëve që japin dëshmi jashtë vendit të gjykimit sipas rregullës 145(1) të Rregullores, takimi i kortezisë mbahet në vendin e dhënies së dëshmisë.<sup>61</sup>

---

<sup>59</sup> Vendimi mbi Informimin e Dëshmitarëve në Çështjen 04, para. 23.

<sup>60</sup> Vendimi mbi Informimin e Dëshmitarëve në Çështjen 04, para. 24.

<sup>61</sup> Vendimi mbi Informimin e Dëshmitarëve në Çështjen 04, para. 25.

#### **4. Rileximi i deklaratës/deklaratave të mëparshme dhe materialeve të lidhura me to**

38. Njëkohësisht me vënien në dispozicion të FID-it për secilin dëshmitar që do të dëshmojë, pala thirrëse duhet t'i bëjë të ditur ZMMD-së numrin e materialeve, gjatësinë e deklaratës/deklaratave dhe sa kohë mendon se i nevojitet dëshmitarit për të lexuar deklaratën e nënshkruar dhe intervistën e incizuar, si edhe çdo dokument a informacion të dhënë nga dëshmitari gjatë dhënies së deklaratës/deklaratave të mëparshme.<sup>62</sup>

39. Me fillimin e procesit të informimit, pala thirrëse i jep ZMMD-së të gjitha materialet e lartpërmendura, për t'i rifreskuar kujtesën. Në vijim, ZMMD-ja i mundëson dëshmitarit qasje në ato materiale për t'i rilexuar. Për të shmangur mosmarrëveshjet e mundshme gjatë seancave gjyqësore, pala thirrëse informon palët jo-thirrëse për materialet në fjalë 3 (tri) ditë para se ato t'i jepen dëshmitarit. Pala thirrëse i jep materialet në gjuhën në të cilën janë dhënë nga dëshmitari, apo në një gjuhë që dëshmitari e kupton lehtësisht. ZMMD-ja mund të mundësojë edhe ndihmë për leximin, në qoftë se është e nevojshme.<sup>63</sup>

40. ZMMD-ja mbikëqyr me vëmendje mirëqenien e dëshmitarit, për të përcaktuar nëse ka nevojë për ndihmë a mbështetje gjatë këtij procesi. ZMMD-ja nuk ka detyrimin të mbajë shënim çfarë thotë dëshmitari gjatë procesit të leximit. Vetëm në qoftë se gjatë leximit ndodh diçka e jashtëzakonshme, ZMMD-ja ia raporton menjëherë palës thirrëse, mbrojtësit të dëshmitarit, nëse ka, dhe Trupit Gjyqësor.<sup>64</sup>

---

<sup>62</sup> Vendimi mbi Informimin e Dëshmitarëve në Çështjen 04, para. 26.

<sup>63</sup> Vendimi mbi Informimin e Dëshmitarëve në Çështjen 04, para. 27.

<sup>64</sup> Vendimi mbi Informimin e Dëshmitarëve në Çështjen 04, para. 28.

41. ZMMD-ja mban evidencë të materialeve që i vihen në dispozicion dëshmitarit, datat kur i janë vënë në dispozicion dhe kohën e kthimit të atyre materialeve palës thirrëse.<sup>65</sup>

## **5. Informimi për masat mbrojtëse**

42. Gjatë takimit me dëshmitarët, ZMMD-ja i informon ata për aspekte që lidhen me mbrojtjen dhe sigurinë e tyre, përfshirë masat mbrojtëse të miratuara, si edhe për të drejtën për të kërkuar masa të tilla sipas rregullës 80(1) të Rregullores. Në bazë të rregullës 80(8) të Rregullores, ZMMD-ja i informon edhe për rrezikun e nxjerrjes së paqëllimshme ose të paligjshme të identitetit apo dëshmisë së tyre, pavarësisht nga masat mbrojtëse të urdhëruara, dhe për mundësinë e ndryshimit të këtyre masave në përputhje me rregullën 80 ose 81 të Rregullores, sipas rastit konkret.<sup>66</sup>

43. Në qoftë se gjatë procesit të informimit, ZMMD-ja has në informacione të reja të cilat beson se mund të justifikojnë një kërkesë për masa mbrojtëse (shtesë), ajo e diskuton këtë me dëshmitarin dhe informon drejtpërdrejt palën thirrëse dhe Trupin Gjykses.<sup>67</sup>

## **6. Informimi për rolin, të drejtat dhe detyrimet**

44. Përpara dhënies së dëshmisë, ZMMD-ja i informon dëshmitarët për rolin, të drejtat dhe detyrimet e tyre si dëshmitarë në DHS, përfshirë detyrimin për të thënë

---

<sup>65</sup> Vendimi mbi Informimin e Dëshmitarëve në Çështjen 04, para. 29.

<sup>66</sup> Vendimi mbi Informimin e Dëshmitarëve në Çështjen 04, para. 30.

<sup>67</sup> Vendimi mbi Informimin e Dëshmitarëve në Çështjen 04, para. 31.

të vërtetën dhe për të bërë betimin solemn para dhënies së dëshmisë, në përputhje me rregullën 141(2) të Rregullores.<sup>68</sup>

45. ZMMD-ja u rikujton dëshmitarëve edhe rregullën 151 të Rregullores lidhur me vetinkriminimin.<sup>69</sup> Në këtë aspekt, përmendet detyrimi i palës thirrëse për të njoftuar Trupin Gjykses për kërkesë të mundshme për garanci sipas rregullës 151(3) të Rregullores.<sup>70</sup>

#### C. PËRGATITJA E DËSHMITARIT

46. Trupi Gjykses vëren parashtrimet e palëve në lidhje me praktikën e përgatitjes së dëshmitarëve.<sup>71</sup> Ai e ka paraqitur mjaftueshëm qëndrimin e vet në Çështjen 04 dhe Çështjen 05 dhe, në këtë çështje gjyqësore, do t'u përgjigjet argumenteve të veçanta në vijim.

47. Trupi Gjykses vëren se ZPS-ja pranon që korniza ligjore e DHS-së nuk përmban dispozita specifike për praktikën e përgatitjes së dëshmitarëve.<sup>72</sup> Fakti që një formë përgatitjeje e dëshmitarëve është kodifikuar tani në nenin 121 të KPPK-së<sup>73</sup> nuk ndikon e as nuk e kufizon kompetencën e gjerë diskrecionale të Trupit Gjykses në këtë aspekt,<sup>74</sup> meqë ky nen nuk është përfshirë shprehimisht në Ligj dhe, rrjedhimisht, nuk është i zbatueshëm.<sup>75</sup> Po kështu, jurisprudenca e gjykatave të tjera ndërkombëtare ose hibride nuk ka fuqi detyruese për këtë Trup Gjykses.

---

<sup>68</sup> Vendimi mbi Informimin e Dëshmitarëve në Çështjen 04, para. 32.

<sup>69</sup> Vendimi mbi Informimin e Dëshmitarëve në Çështjen 04, para. 33.

<sup>70</sup> *Shih* Vendimin mbi Zhvillimin e Gjykimit, para. 64-66.

<sup>71</sup> *Shih më lart* para. 6-18.

<sup>72</sup> *Shih më lart* para. 7.

<sup>73</sup> *Shih më lart* para. 7.

<sup>74</sup> Vendimi mbi Informimin e Dëshmitarëve në Çështjen 05, para. 35-36. *Shih më lart* para. 13.

<sup>75</sup> Neni 3(2)(c) i Ligjit.

48. Gjithashtu, Trupi Gjykues konfirmon edhe një herë konstatimin e vet të mëparshëm se procesi i informimit të dëshmitarëve i kryer nën kujdesin e ZMMD-së u jep mundësi dëshmitarëve të përgatiten mjaftueshëm për dhënien e dëshmisë, përfshirë nëpërmjet rileximit të deklaratave të mëparshme dhe materialeve të lidhura me to.<sup>76</sup> Trupi Gjykues konfirmon sërish edhe konstatimin e tij se ZMMD-ja është subjekti më i përshtatshëm për të ofruar shërbime mbështetëse dhe për të informuar dëshmitarët në lidhje me çdo temë që përbën shqetësim, për të trajtuar çdo frikë që mund të kenë, si dhe për të marrë informacione për ndërhyrje të pretenduara.<sup>77</sup> ZPS-ja nuk shpjegon se pse, në një atmosferë të frikësimit të dëshmitarëve, *vetëm* ZPS-ja është më mirë në gjendje t'ua zbusë frikën dëshmitarëve dhe të marrë informacione të tjera lidhur me ndonjë ndërhyrje të pretenduar, dhe jo ZMMD-ja, njësia e specializuar në kuadër të Zyrës Administrative, së cilës me këtë vendim i ngarkohet detyra që t'i përcjellë Trupit Gjykues vërejtjet e dëshmitarëve gjatë procesit të informimit të tyre.<sup>78</sup>

49. Trupi Gjykues vëren gjithashtu se ngjarjet objekt i gjykimit ndodhën në prill 2023, dëshmitarët e ZPS-së janë intervistuar kohët e fundit dhe dëshmitarët mund të jenë të informuar për procedurat gjyqësore nga përvoja të mëparshme. Sipas Trupit Gjykues, ngjarjet janë të freskëta në mendjen e dëshmitarëve (të ZPS-së) dhe, krahas kësaj, ata mund ta rifreskojnë kujtesën me rileximin e deklaratave të mëparshme. Përgatitja e mëtejshme nga pala thirrëse është e panevojshme.

50. Sa i takon argumentit të ZPS-së lidhur me përdorimin efektiv të kohës në sallën e gjyqit dhe duke pasur parasysh disa prova të caktuara që do të paraqiten në këtë çështje gjyqësore,<sup>79</sup> Trupi Gjykues rikujton se pala thirrëse është e aftë t'i

---

<sup>76</sup> Shih më lart para. 38-41. Shih edhe Vendimin mbi Informimin e Dëshmitarëve në Çështjen 04, para. 34.

<sup>77</sup> Vendimi mbi Informimin e Dëshmitarëve në Çështjen 05, para. 41.

<sup>78</sup> Shih më lart para. 42-43.

<sup>79</sup> Shih më lart para. 17.

bëjë pyetjet e saj në mënyrë efikase dhe Trupi Gjykses ka kontroll mbi mënyrën e bërjes së pyetjeve dhe mund të ndërhyjë në qoftë se do të jetë e nevojshme.<sup>80</sup>

51. Mbështetur në sa më lart, Trupi Gjykses nuk e gjykon të përshtatshme të devijojë nga praktika e mëparshme në Çështjen 04 dhe Çështjen 05 dhe, rrjedhimisht, nuk do ta trajtojë më tej pikën e përgatitjes së dëshmitarëve.

## V. VENDIM

52. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a. **UDHËZON** palët dhe ZMMD-në të mundësojnë informimin në tërësi të dëshmitarëve në përputhje me paragrafët 24-45 të këtij Vendimi; dhe
- b. **RRËZON** kërkesën e ZPS-së për miratimin e një protokolli për përgatitjen e dëshmitarëve.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Mapi Feld-Folia

Kryegjykatëse

/nënshkrimi/

Gjykatës Zhilber Biti

/nënshkrimi/

Gjykatës Roland Dekers

E mërkurë, 13 nëntor 2024

Hagë, Holandë.

---

<sup>80</sup> *Shih* në përgjithësi për diskutimin e Trupit Gjykses në Vendimin mbi Informimin e Dëshmitarëve në Çështjen 05, para. 35-42.